



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 81-të të mbajtur më 03.02.2023 ka miratuar si në vijim.

Propozim - VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1141/1 të datës 12.03.2021, me pretendime për diskriminim të vendit të punës ///, HIDHET POSHTË .

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent në rastin e lëndës.

Lënda me numër 12-1141/1 të datës 12.03.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 12.03.2021, është dorëzuar denoncim me pretendime për diskriminim të vendit të punës dhe është formuar lënda me numër 12 -1141 të datës 12.03.2021

Në denoncim, parashtruesi thekson se që nga viti 1998 ka qenë i punësuar në _____, në detyrën oficer i shërbimit veterinar. Në vitin 2020, me urdhër të _____, ai u zhvendos dhe u vendos në një pozicion të papërshtatshëm - _____ në 4 ekiye në _____, me kualifikime tjera profesionale, arsim dhe përvojë të punës, të ndryshme me të cilat i posedonte parashtruesi. Ai beson se me miratimin e aktit për zhvendosjen dhe trajtimin, mosparashtrimi i përgjigjes ndaj ankesës nga punëdhënësi, mohimi i të drejtave të punës dhe vënia e tij në pozitë të pabarabartë, është diskriminuar drejtpërdrejt. Ndërsa me miratimin e aktit nënligjor – _____ shuma e shtesës së pagës për kryerjen e një _____ të _____ dhe _____, në _____ pozitën e vendosur në _____ - baza diskriminuese në krahasim me personat e _____

tjerë, gjatë së cilës ai ka qenë subjekt i diskriminimit dhe ngacmimit indirekt në vendin e punës. Ai informon se ka parashtruar ankesa tek Avokati i Popullit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Inspektori për Personel dhe të Drejtat e Qytetarëve - _____

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstaton se denoncimi ka të bëjë me pretendime që nuk janë objekt i veprimit kompetent të KSHPK-së, por bëhet fjalë për pretendime që kanë të bëjnë me një çështje që lidhet me veprimin kompetent të një autoriteti tjetër kompetent, në rastin konkret Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi i cili në pajtim me nenin 21 paragrafi 1 pika 14 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 258/20), është kompetent për të vepruar sipas kërkesave për raste të veçanta të diskriminimit.

Nga këtu KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka kompetencë për veprim në rastin e lëndës.

Në bazë të së theksuarës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Dorëzuar deri te:

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.M.

Miratoi: G.T, anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËRORE PËR
PARANDALIMIN KORRUPSIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska**